



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:278739
Datë: 28.09.2020
Numri i dokumentit: 01144456

C.nr. 1392/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, sipas gjyqtarit, Besnik Shala, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit R.S me banim në rr. “.....” nr... P, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. E.M nga Peja, kundër të paditurave K.P dhe M.M me adresë në rr. “.....” p.n. Pejë, me bazë juridike vërtetim pronësie në bazë të mbajtjes, vlera e kontestit 3.100 euro, jashtë seance me datë 18.12.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRËHEQUR padia e paditësve paditësit R.S me banim në rr. “.....” nr....., P, kundër të paditurave K.P dhe M.M me adrës në rr. “.....” p.n. P, me bazë juridike vërtetim pronësie në bazë të mbajtjes, vlera e kontestit 3.100 euro.

A r s y e t i m

Paditësit pranë Gjykatës Themelore në Pejë, me datë 11.11.2019, ka ushtruar padi kundër të paditurave, me bazë juridike vërtetim pronësie në bazë të mbajtjes, vlera e kontestit 3.100 euro.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 17.11.2020, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë ndaj të paditurave, për shkak se nuk ka interes juridik të vazhdoj këtë procedurë juridiko pronësore.

Sipas dispozitës së nenit 261.1, LPK-së, e cila parashikon se paditësi mund ta tërheqë padinë, pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin, në të cilën i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjersa paragrafi 2, parashikon se padia mund të tërhiqet edhe më vonë gjerë në përfundim të shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda afatit prej 7 dite, nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Gjykata duke ju referuar të cekurave me lartë, të paditurave i ka dërguar njoftimin siç parashihet me nenin 261 par. 2, të LPK-së pasi që të paditurat ka qenë e njoftuar për procesin dhe kanë parashtruar përgjigje në padi, ndërsa njoftimin e paditura e par e ka pranuar me datë 23.11.2020, dhe e paditura e dytë me datë 10.12.2020, dhe nuk janë përgjigjur, andaj pasi që të paditurat nuk

janë përgjigju fare në njoftimi e gjykatës konsiderohet se kanë dhen pëlqimin për tërheqjen e padis nga ana e paditësit.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 2, 3, dhe 4 e lidhur me nenin 387, të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm
C. nr. 1392/19, datë 18.12.2020.**

Gjyqtari
Besnik Shala

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa,
Konform nenit 261 pra.4 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2019:278739
Datë: 28.09.2020
Numri i dokumentit: 01144456